

UDHA ISLAMIE

Viti XI - Nr. 11 (129), Nëntor, 2013

Organ i Myftinisë Shkodër

E përmuajshme Informative-Fetare-Kulturore-Edukative

SIRIA - PLAGË ZEMRE...





Dr. Mustafa Mahmud

ILAÇ PËR ÇDO SËMUNDJE

përtëritëse të më të Madhit Shpikës (Krijues).

Do të thotë që syri të lavdërojë, veshi të madhërojë, gjuha të falënderojë, qenia të tretet dhe zemra të shtanget.

Do të thotë që zemra të shpërthejë nga burimi i ndjenjave e ndjeshmëria të festojë çdo moment dhe shpirti të gëzojë çdo ditë që lind, sikur ajo është dasëm e re.

Do të thotë të mos njohim pesimizëm dhe të mos shijojmë dëshpërim...

Do të thotë që hallet tona të treten në prehrin e mëshirës së Mëshiruesit dhe faljes së Falësit...

A nuk na thotë Zoti ynë: "Me vësh-tirësi ka lehtësim" (Sherh: 6) dhe se halli vjen e në palët e tij është ngushëllimi... çfarë sihariqi të dërgoj për qetësimin nga këto përgëzime.

Dhe, se Allahu i Lartmadhëruar... është Një... kurrë nuk do të shkapërderdhemi dhe kurrë nuk do të na shpërndajnë drejtimet e kurrë nuk do të ndahemi mes besnikërisë djathtas, apo asaj majtas, afrimite-tit nga Lindja, apo asaj nga Perëndi-

mi dhe as përgjërimit të të pasurit e mbështetjes të të fortit. E gjithë forca është tek Ai, e gjithë pasuria është tek Ai, e gjithë dituria është tek Ai dhe çdo gjë që shpresojmë ndodhet përpara Tij. Arratisja nuk është prej Tij, por tek Ai. Ai është vatan, mbrojtja, strehimi, mbështetja, baza, dera dhe mirëpritja.

Gjithë kjo ndjeshmëri do të thotë qetësi, prehje, çlodhje truri, shpresë, nxitje, energji, optimizëm, entuziazëm, punë pa mërzitje, pa lodhje e pa dembelizëm dhe ky është fryti i "La ilahe il-lall-llah" (Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut) në zemrën e atij që e thotë, i cili e ndjen, e personifikon, e beson dhe e jeton atë.

Ky është ilaçi që mjekon çdo sëmundje të njerëzve, shëron çdo sëmundje mendore e i pastron të gjitha sëmundjet e zemrave.

Kjo është thirrja e çlirimit, e cila shkatërron prangat e duarve dhe zinxhirët e qafës e të këmbëve. Ajo është çelësi i energjisë së fshehur brenda nesh, fjala sekrete që lëviz malet, çan detet dhe ndryshon atë që nuk mund të ndryshojë.

Deri tani akoma nuk është krijuar qetësuesi magjik, i cili mund të prodhojë te njerëzit qoftë edhe një grimcë të vetme prej këtij ndikimi.

Të gjithë qetësuesit e dhimbjeve mjekojnë diçka, por dëmtojnë me të mijëra gjëra të tjera. Ato mjekojnë iluzionin, e qetësojnë njeriun të shuajë dritën e mendjes, e vënë në gjumë, ia tërheqin vëmendjen dhe e hedhin në fund të detit të lidhur me gur pas qafe, në gjendje të pavetëdijshme, gjysmë të vdekur.

Ndërsa fjala "La ilahe il-lall-llah" (Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut) ajo e çliron njeriun nga prangat e tij dhe e çliron prej të gjitha skllavërive të kota. E përgëzon me faljen, e shpëton prej frikës, e mbron nga vesveset

Zonja dhe zotërinj, a e dini se çfarë do të thotë Allahu ekziston? Do të thotë se

Drejtësia ekziston, mëshira ekziston dhe falja ekziston...

Do të thotë që zemra qetësohet, qenia çlodhet, mendja pushon, shqetësimi largohet dhe e vërteta patjetër do të mbërrijë te të zotët e saj.

Do të thotë se gjaku nuk shkon kot, durimi nuk kalon pa dhënë fryte, mirësia nuk mbetet pa shpërblim (kompensim), sherri (e keqja) nuk kalon pa pengesë dhe krimi nuk shpëton pa u ndëshkuar...

Do të thotë se bujaria është ajo, e cila sundon ekzistencën dhe jo koprracia... dhe se nuk është prej natyrës së Bujarit të marrë atë që ka dhënë. Kështu, pasi Allahu është Ai që na dha jetën, atëherë Ai nuk mund ta marrë atë me vdekje dhe se vdekja nuk mund të jetë marrëse e jetës. Por, ajo është kalim për te një botë tjetër pas vdekjes, pastaj jetë tjetër pas ringjalljes, pastaj ngjitje në qiell për në pafundësi.

Do të thotë se nuk ka kotësi në ekzistencë, por urtësi në çdo gjë... dhe urtësi pas çdo gjëje. Urtësi në krijimin e çdo gjëje. Në dhimbje urtësi, në sëmundje urtësi dhe në ndëshkim urtësi. Në vuajtje urtësi, në shëmti urtësi, në dështim urtësi, në pamundësi urtësi dhe në aftësi urtësi...

Do të thotë të mos ndalesh nga mrekuillimi, të mos ndalesh nga mahnitja, të të mos ndërpritet habitja, të të mos ndalojë madhërimi, sepse ne ndodhemi përpara një tabloje ri-

Sepse Allahu ekziston
ti nuk je vetëm,
por ty të rrethon
përkujdesja
kudo që të shkosh
dhe të mbron vullneti
(i Zotit)
kudo që të qëndrosh.

dhe e mbështet me Fisnikët e Lartë (engjëj) duke e bërë më të lartë se qielli në shpresë dhe më të fortë se toka në qëndresë. Kushdo që hallet e tij i depoziton tek Allahu ai është ngrysur me plot vetëbesim dhe ka fjetur sy ngopur.

Dhe, sepse Allahu, Ai është krijuesi i gjithësisë, Përcaktuesi i kadereve dhe Qarkulluesi i fateve, prandaj nuk ka mundësi më të mirë se sa ajo që është shpikur (krijuar). Sepse Ai është Shpikësi (Krijuesi) pa përngjasim, askush nuk mund t'ia kalojë në krijimin e Tij dhe askush nuk mund të krahasohet me Përsosmërinë e Tij. Bota kurrë nuk do të kthehet në arenë gjaku të keqbërësve, por ajo është mësim i lartë prej mësimeve të urtësisë.

Sepse Allahu ekziston ti nuk je vetëm, por ty të rrethon përkujdesja kudo që të shkosh dhe të mbron vullneti (i Zotit) kudo që të qëndrosh.

Kjo do të thotë ndjeshmëri e vazhdueshme për miqësi, shoqëri dhe siguri. Nuk ka braktisje, nuk ka tradhti, nuk ka disfatë, nuk ka vetmi, nuk ka trishtim dhe nuk ka mërzitje.

Kjo është gjendja e shqiptuesve të "La ilahe il-lall-llah" (Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut).

Shijojnë erën e xhenetit në dynja, përpara se të hynë në të në botën tjetër. Ata janë mbretërit pa fron dhe pa topuz. Ata janë qëndrestarët, të bindurit të vendosur që nuk i tronditin tërmetet dhe as nuk i tundojnë sprovat.

Ky është ilaçi hyjnor për çdokënd që e ka pushtuar shqetësimi, në të është mjekimi i vetëm. Në të është eliksiri kundërveprues dhe uji i jetës, të cilin kush e pi nuk ka etje më pas tij. Në të është depozitimi i artë dhe mbështetja për çdo gjë që shkëmbejmë mbi sipërfaqen e tokës prej monedhave dhe kartëmonedhave të përkohshme që qarkullojnë. Në të është busulla, orientimi dhe udhëzuesi... në të është ilaçi për çdo sëmundje.

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja



Shtegtim nostalgjie drejt Xhamisë së Plumbit



Ditën e xhuma, më 15 nëntor 2013, Myftinia Shkodër ka organizuar një “Shtegtim nostalgjie...” drejt Xhamisë së Plumbit, në prag të përkujtimit të 23 vjetorit të rihapjes së saj, më 16 nëntor 2013, që shënoi edhe rilejimin e praktikës fetare në Shqipërinë e shkatërruar nga çmenduria ateiste e sistemit politik më të devijuar të historisë së 20 shekujve të fundit të njerëzimit.

Me këtë rast, besimtarë të shumtë kishin mbërritur në Xhaminë e Plumbit për të falur namazin e xhumasë, duke dëshmuar njëkohësisht mrekullinë e besimit dhe përkushtimin e zemrave.

Fillimisht, në prag të namazit të xhumasë, aktivitetin e ka përshëndetur Myftiu i Shkodrës Imam Muhammed Sytari, në fjalën e të cilit janë dëshmuar emocionet dhe nostalgjia e 23 viteve të fundit, në të cilat aktiviteti islam në Shkodër e Shqipëri ka pësuar në vijimësi rritje dhe zhvillim të dukshëm. Myftiu ka kërkuar që të respektohen të gjithë ata që u angazhuan për të ardhur kjo ditë e shënuar për mbarë muslimanët e Shkodrës. Njëkohësisht ka kërkuar nga të rinjtë e shumtë të pranishëm në xhami, që të mos harrojnë asnjëherë këtë datë dhe ta mbrojnë besimin si shenjtërinë kryesore të jetës.

Myftiu ka lexuar për të pranishmit

edhe procesverbalin e parë të themelimit të Bashkësisë Islamike Shqiptare në Shkodër, më 16 nëntor 1990, si dhe ka përmendur emrat e nderuar të gjithë firmëtarëve që shënuan emrat e tyre në historinë e ripërtëritjes së Thirrjes Islame në Shkodër e Shqipëri, pas viteve ‘90.

Edhe Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu, e ka përshëndetur tubimin e kësaj xhumaje të shënuar, duke theksuar se liria e besimit është një ndër vlerat më të spikatura të një populli. Ai ka bërë një homazh respekti për të gjithë ata nismëtarë për rihapjen e xhamisë së Plumbit, që sot nuk janë më, sikurse ka shprehur vlerësimet e tij për Myftininë Shkodër dhe aktivitetin e saj në këto 23 vjet, në rrugën e mbrojtjes dhe kultivimit të vlerave në Shqipëri.

Në nderim të kësaj ngjarje, i pra-

nishëm në këtë aktivitet përkujtimor ka qenë edhe Nën/Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, që ka mbajtur edhe hytben e kësaj xhumaje të shënuar. Në hytben e xhumasë të mbajtur me këtë rast, nën/kryetari i KMSH, ka vlerësuar rolin e madh dhe kontributin e Kryetarit të parë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. H. Sabri Koçi në rimëkëmbjen islame në vitet e para të demokracisë.

Në hytben e tij, H. Bujar Spahiu ka vënë theksin te nevoja e madhe që ka njeriu për të ruajtur besimin e tij dhe për t’u udhëzuar në rrugën e mësimave të fesë, të mbrojtura në Kur’an dhe të praktikuara në mënyrën më të mirë në traditën e Hz. Muhammedit (a.s).

Nën/Kryetari i KMSH, ka nxitur frymën e harmonisë dhe respektit që besimtarët duhet të kenë në mes vete dhe me besimtarët e feve të tjera në rrugën e forcimit të mëtejshëm të frymës së besimit dhe mësimave të pastra me të cilat feja orienton besimtarët.

Në përfundim të kësaj xhumaje përkujtimore, të pranishmit kanë marrë pjesë në koktejlën e shtruar me këtë rast, si dhe kanë vizituar fotoekspozitën e instaluar në brendësi të safallekut të xhamisë së Plumbit.

I pranishëm në këtë ceremoni të shënuar ka qenë edhe H.H. Musa Hoxha, i fundit prej nxënësve të përkushtuar të hoxhallarëve të vjetër të Shkodrës, bashkëmoshatar dhe shok dersi me H.H. Sabri Koçin, H. Sulejman Krajën, H. Qamil Tresin etj.



Ishe, mbete, je “Mevlana”...



Në dyert e mezarit¹ tënd, Mevlana, ora ndal hapat e minutave rutinë, për të cilët është bërë pishman prej kohësh... Merr frymë malli për kohë njerëzish të bardhë me zemra të mbuluara me dashni për Dhuruesin e tyre, Bujar...

Për pak çaste, si në një mirazh shpirti, bashkohet me ta, si pjesë e një "Ehli-Bejti", dyert e të cilat nuk mbyllen kurrë... Dashuria, ajo sundon në hapësirat e këtij mexhlisi, si ajo për të cilën thërrisje, kur zemra jote i drejtohej KRIJUESIT: "O i Dashur! Asnjë kënaqësi në të dy botrat nuk kam gjetur pa Ty! Kam parë shumë çudira, por nuk kam parë çudi më të madhe sesa Ty! ... Ah, sa herë e kam vënë veshin e shpirtit në dritaret e zemrës, kam dëgjuar shumë fjalë, por... nuk i kam parë buzët..."

Ngjyrë, si e bardha e mjekrës tënde merr fryma, teksa aty bri teje, një "Fatiha" drejt dyerve të lutjes dërgoj... Nëpërmjet fjalëve të tua, përreth dominon ngjyra e paqes, që dhuron ftesa e jote: "Lulet që çelin në pranverë, vdesin në vjeshtë, ndër-sa kopshti i dashurisë nuk ushqehet nga pranvera. Ato lule që pranvera sjell plot ferra, janë si vera e lëngjeve që nuk pastrohet asnjëherë nga llumi. Prandaj, mos u dridhëro mbi kështjellat e trupit, por ec duke vrapuar mbi këmbët e tua! All-llahu i dhuron krahë atij që heq dorë nga kështjellat e trupit!"

1. Mezar – varri.

Ishe, mbete, je "Mevlana" i mikpritjes së të përlyerve në hutimet e kësaj bote... Ishe, mbete, je "Mevlana", mik i ashikëve me emrin e Hakut në shpirt...! Ishe, mbete, je "Mevlana" këshillues i mirë: "Shihe pak veten, dil nga aty dhe largohu nga burgu i botës së formave drejt vendit të kuptimeve, sepse ti je zog i botës së shenjtë, i penduar i ndenjave të qetësisë... Është e ulët të vazhdosh të qëndrosh në këtë pozitë!"

Ishe, mbete, je "Mevlana", me porosi të urtë në kohën e ndarjes nga kjo botë kalimtare: "... Qëndroni larg së keqes dhe mëkatit. Të kontrolloni veprimet tuaja dhe të jeni këmbëngulës në agjërim. Hani pak, flini pak, flisni pak. Qëndroni larg lakmive epshore me të tëra forcat. Duroni ofendimet që u bëjnë të tjerët. Bëni shoqëri me njerëz zemërmëdhenj e të përshpirtshëm. Njeri i mirë është ai që u bën mirë të tjerëve dhe këshilla më e mirë është ajo që i drejton njerëzit drejt së mirës..."²

Muhamed Sytari,
Konja (Turqi), 8 nëntor 2013

2. Pjesët që i atribuohen Mevlanës i kam përkthyer në shqip nga gjuha arabe, bazuar në veprën e Dr. Muhammed Abdusselam Kefafi, "Methnevi Xhelaluddin er-Rûmi", përkthyer në arabisht, (shpjegim dhe studim), vëllimi I, Bejrut, 1966. (M.S.).

Mora abdes,
m'u largua mërzia
nga zemra...

Bëra sexhde,
u qetësua
shpirti im...

U binda
se pa DHIKRIN
e Zotit tim
nuk mund të bëj
përpara...

Nurlan Mamedzade

E PRISHËT PSIKOLOGJINË E RINISË!

Një burrë i të gjashtëdhjetave po hynte në një restorant të madh, mu në qendër të qytetit, aty ku pjesa më e madhe e pjesëmarrësve janë të rinj. Kish-te kohë që s'vinte në kryeqytet. E ndjeu veten si të ishte një i huaj i një tjetër planeti kur kaloi në rrugët e stolisura, të cilat kur i shihte në televizor u dukeshin si një tjetër botë. Qe shumë i uritur. Sado që kërkoi, nuk arriti t'i gjejë, ato mensat e dikurshme modeste të vogla të viteve universitare ku shkonte shpesh me shokët. E ndërkohë që po i kthehej atyre viteve të rinisë, seç nuhati për një çast një aromë të këndshme që vinte nga një kuzhinë aty pranë, e megjithatë nuk gjeti atë që kërkonte. Më në fund, duke pyetur njerëzit gjatë rrugës kish mbërritur deri këtu, qe detyruar të futej deri brenda. Në

fakt me të hyrë e kish kuptuar që aty nuk ishte thjeshtë vetëm një lokal. Ambienti shumëkatësh, në brendësi të së cilit kishte sallone sportive, pishina, lojëra fati, makina lojërash të modeleve të fundit, ishte si një qytezë e vogël ku strehoheshin me qindra e mijëra individë njëherazi. Ishte e para herë që i moshuari vinte në një vend të tillë, natyrshëm koka qe turbulluar.

Po priste në radhë, përpara një dyqani ku me ngjyrimë shumëngjyrëshe dhe me të madhe shkruhej "FAST-FOOD", natyrshëm për të porositur ushqimin. Kishte shumë të tillë si ai që prisnin në radhë. Secili merrte diçka dhe zinte vend në tavolinat e rreshtuara aty përpara dritareve të xhamta. Mendoj pakëz me vete:

-Ç 'mënyrë ngrënieje është kjo!

Si hahet në këmbë? E për më tepër duke parë nga jashtë, në sy të njerëzve kalimtarë... A nuk ekziston në këtë vend haku i të uriturit? Vendosi të shihte pak rreth e përqark. Nisi të fliste me një djalosh që priste edhe ai në radhë:

-Si të quajnë bir!?

-Sinan!

-Ç 'moshë ke?

-Njëzet e pesë!

-Vjen shpesh këtu?

-Po xhaxha, të paktën një herë në dy ditë vijmë bashkë me shokët. Jemi një ekip i mrekullueshëm. Nganjëherë rrimë këtu që nga mëngjesi deri në darkë.

-I moshuari nuk zinte dot vend pa e bërë edhe një pyetje:

-A nuk punoni?

-Jo, po ç 'punë thua ti, vetë jeta është e shkurtër, e ç'na ngeli pastaj, ta jetojmë jetën vetëm duke punuar?

-Ku i gjeni paratë bir?

-Rrofshin baballarët, - iu përgjigj djaloshi si i ndrojtur dhe nëpër dhëmbë, - çdo ditë kemi të holla në xhep. Por edhe ne nuk është se nuk fitojmë. Një herë në muaj apo edhe në dy muaj del diçka nga lotot.

-Ashtu ëëë!? pëshpëriti i moshuari dhe më pas vijoi sërish të pyesë:

-The pak më parë se të quajnë Sinan. E njeh Arkitekt Sinanin?

-Për Zotin xhaxha, e di që ka një Universitet që quhet Arkitekt Sinani, kaq. Me kalimin e kohës se çfarë qe bërë, mjeshtër apo punëtor, nuk di të të them! – tha kështu djaloshi i ri që mbante edhe vathë në vesh, i cili këtë herë e shtyri lehtëzi të moshuarin drejt radhës që po lehtësohej.

-Jepi xhaxha, radha të pret ty.



I moshuari e vuri re që i kish ardhur radha, por në padijeninë e tij se çfarë do të porosiste i vënë në dyshime dhe në mënyrë të pavullnetshme tha: "A mund të më jepni një gazozë?" Në të vërtetë ushqimet që ofroheshin këtu nuk ishin nga ato që ai dëshironte. Me të marrë gazozën nxitoi me hapa të shpejtë për të dalë jashtë nga salloni i lokalit të ndërtesës madhështore. Koka i qe bërë lëmsh. Ç' rini ishte kjo?! Nuk shihte asnjë më të mençur dhe më të madh se vetja. I pëshpëritën në vesh fjalët e dy të rinjve që po kalonin pak më parë aty pranë dhe teksa flisnin me njëri-tjetrin thoshin me mburrje: "jam unë more, mbreti i botëve!"

Ky zë që thuajse dilte nga thellësitë sa vinte e bëhej edhe më i fuqishëm. Vërtet, kështu ishte rritur ky brez. Pasi sa e sa të tillë që s' shihnin tjetër veç vetes së tyre, që veten e pandehte mbret në sistemin ku jetonte, në të vërtetë s' kishte arritur ta mendonte se si mbreti dhe ushtari janë veçse një lojë, ndërsa dora që i vë në lojë ato i përket dikujt tjetër. Pasi çdokush që kishte marrë përsipër të luante në këtë lojë shahu qe fiksuar pas bukurisë së formatit bardh e zi, mbi të cilën ecte dhe s' kishte qëllim tjetër veç të dilte në finale brenda këtij formati dhe të bëhej mbret me çdo kusht. Pasi me finale këtu nënkuptohej mbreti i botës. Askush nuk synonte të bënte punën e tij, pra të shpëtonte nga të qëniti ushtar në këtë rregull të ngritur.

Nuk e dinte se nga i vinte një përzierje stomaku, nga uria apo nga tymi i duhanit që kish ndezur me të dalë nga salloni. Ndoshta i rrihte zemra, e pandehte se i përzihej stomaku. Pyeti se ku ndodhej tualeti, por ç'të shihte, edhe aty kish shumë njerëz, hyri në radhë. Kishte shumë njerëz që prisnin radhën. Pse vallë të ishte kaq i vogël tualeti i një ndërtese kaq të madhe. Si ti linin në pritje për inat të njerëzve. Për më tepër që tualeti i grave dhe i burrave qe ballë për ballë. Në pritje e sipër

kishte vajza të reja me pantallona të ngushta që nxirrnin pasqyrën e vogël për të freskuar makijazhin. Ashtu siç kishte edhe nga ana tjetër prej atyre meshkujve që nuk i linin të qeta. Për një çast kujtoi ditët kur sapo kishte filluar punën. Duke qenë se në njërin prej dhomave pranë tualeteve të shkollës ku jepte mësim punonin gratë, ai zbriste në tualetin e një xhamie që kish pranë. Kurse tani bashkë me emrin e vendit në fjalë ku me të mëdha shkruhej WC kish ndryshuar edhe kultura e tualetit. Pëshpëriti si në vetvete:

-Shiko shiko si është katandisur kjo rini! Dhe për një kohë priti ashtu...

Nëpër shkallë po jehonte zëri i një burri tek të gjashtëdhjetat që dëshironte të dilte përjashta ndërkohë që çdokush ishte bërë pjesë e argëtimeve. Ata që e dëgjonin zërin ndjenin keqardhje për klithmat e burrit duke kthyer kokën nga pas tek e shihnin, e ndërkaq ai me zë të fortë thoshte:


-E prishën rininë e këtij populli. Rritën një rini që rri duke pritur përpara lokalit. E prishën rininë e popullit. E larguan nga sexhdeja duke e lënë edhe ushqimin ta hanë në këmbë. Rritën një brez që pret vazhdimisht radhën përpara tualetit pasi ka ngrënë mirë e mirë deri në

fryrje, një rini që u plak duke pritur. Turp të kini! Një rini me ide, më dhikr, me bark të ngopur dhe famë, aman aman! Një rini, truri i së cilës ka marrë një aromë të pakëndshme duke pritur gjatë e gjatë para tualetit... E prishën psikologjinë e rinisë. Dhe më pas u shfaqën "dijetarët" e gjalluar që prodhojnë ide të habitshme duke ngrënë gjëra të pavlera. E kthyen rininë në një të huaj për veten, atë rini që pret të fitojë nga lojërat e fatit dhe për rrjedhojë e ka ngurtësuar atë anë të mendjes që prodhon ide dhe mendime dhe që e ka përvetësuar mënyrën e të jetuarit në bashkësi. Turp të kenë, e prishën psikologjinë e rinisë!...

Në këto rrethana një baba që mbante përdore të birin, të cilin po e ngjiste lart përmes shkallëve, ndërkohë që mori të birin të mbante në krahë dhe me të shpejtë po përpiquej të largohej nga mjedisi në fjalë, nga ana tjetër iu drejtua të shoqes, e cila me hapa të shpejtë po e ndiqte atë nga pas duke parë me habi edhe burrin që po "rënkonte", duke i thënë:

Shpejt grua të ngjitemi lart! Shpejt, ndryshe do i prishet psikologja fëmijës!...

*Përktheu nga turqishtja:
Evans Drishti*



DOKUMENTARI I MYFTINISË SHKODËR NË PËRKUJTIM TË 16 NËNTORIT 1990



Mbrëmjen e së shtunës, më 16 nëntor 2013, nëpërmjet valëve të Tv Rozafa, Myftinia Shkodër ka shfaqur një dokumentar, me dëshmi dhe fakte konkrete mbi rihapjen e Xhamisë së Plumbit. Ky dokumentar shfaqet në kuadër të përkujtimit të datës së shënuar 16 nëntor 1990, ditë në të cilën u plotësuan kushtet për rihapjen e Xhamisë së Plumbit, pas një periudhe të errët 23 vjeçare, në të cilën shteti shqiptar mbylli shkollat fetare, shkatërroi xhamitë, ndaloi mësimin e edukatës fetare në shkollat e tij dhe u vetë-deklarua si “shteti i vetëm ateist në botë”.

Gjatë këtij dokumentari, teleshikuesit kanë pasur mundësi të dëgjojnë dëshmi të ndryshme rreth kushteve të vështira në të cilat muslimanët shkodranë mbanin fshehurazi ritet dhe adhurimet islame në periudhën e ndalimit të tyre me ligj. Njëkohësisht janë dhënë dëshmi për ditën e 16 nëntorit 1990, të cilat bartin përherë emocione dhe respekt për të gjithë kontribuesit dhe mbi të gjitha, zgjojnë ndjenjën e falënderimit ndaj All-llahut (xh.sh) që nuk e humbi këtë besim dhe këtë fé të pastër në këtë tokë islame.

Në dokumentar përftohen emocione të mëdha teksa dëgjohe dëshmi

të ndryshme nga H. Mit'hat Myftija, rahmetliu H. Faik Zaganjori, si dhe dëshmohen pamje vizive të hoxhallarëve të nderuar si: H. Sabri Koçi, H. Sulejman Kraja etj, që nuk jetojnë më.

Dokumentari në fjalë transmetohet për herë të parë në një media vizive. Ai u ideua dhe u mbështet nga Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari dhe u realizua nga gazetarë dhe operatorë profesionistë të qytetit të Shkodrës, me rastin e 20 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit dhe dëshmimit të lirë të vullnetit dhe përkatësisë fetare në vendin tonë.



Myftiu viziton Drejtorin e ri të Policisë së Qarkut Shkodër



Ditën e hënë, më 18 nëntor 2013, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed Sytari ka zhvilluar një vizitë nderi në zyrën e Drejtorit të ri të Policisë së Qarkut Shkodër, z. Shaban Nexhi.

Fillimisht Myftiu ka uruar Drejtorin e ri të Policisë së Qarkut Shkodër me rastin e marrjes së detyrës së re, si dhe ka shprehur falënderimet e tij për bashkëpunimin e deritanishëm me Policinë e Shkodrës në situata të ndryshme të këtij bashkëpunimi.

Drejtori i Policisë së Shkodrës, z. Shaban Nexhi, ka konfirmuar edhe një herë gatishmërinë e Policisë së Qarkut Shkodër për të qenë pranë Myftinisë Shkodër në çfarëdo nevojë, në rrugën e përmirësimit të cilësisë së bashkëpunimit në mes dy institucioneve dhe interesit social.

Biseda është përqendruar edhe në çështje konkrete që lidhen me aktivitetin e gjerë të Myftinisë Shkodër dhe nevojën e herë pas herë për bashkëpunimin me Policinë e Shkodrës.

Drejtori i Policisë ka shprehur vullnetin e tij dhe të institucionit që drejton për të qenë të gatshëm për të ndërhyrë në çdo moment kur Myftinia Shkodër do të ketë nevojë, sidomos në raport me çështjen e pronave dhe moscënimin e tyre, mosprekjen e shenjtërisë së xhamive të saj etj.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës i ka dhuruar Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër një kopje të Kur'anit me përkthimin e kup-timeve të ajeteve të tij në gjuhën shqipe.

Myftiu zhvillon një takim pune me Kryetarin e Bashkisë Shkodër

Ditën e martë, më 19 nëntor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka zhvilluar një takim pune në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, z. Lorenc Luka.

Qëllimi i këtij takimi kanë qenë problematikat që lidhen me disa nga pronat e Myftinisë Shkodër, që presin ndërhyrjen e Bashkisë për t'u liruar dhe vënë në dispozicion të pronarit legjitim, pas plotësimit të krejt kushteve ligjore.

Në takim është diskutuar edhe për interesimin e përbashkët të Myftinisë dhe Bashkisë Shkodër në lidhje me Xhaminë e Plumbit dhe zonën përreth saj, si një ndër lagjet më të vjetra monument kulture në Shkodër.

Siç dihet, Myftinia dhe Bashkia Shkodër janë interesuar që herët për të përgatitur një projekt ambicioz që e shpëton përfundimisht Xhaminë e Plumbit nga situatat e përmbytjeve

dhe neglizhencës së viteve të fundit. Projekti në fjalë i është dorëzuar Ambasadës së Kuvajtit në Tiranë, pas premtimit të bërë nga Qeveria e Kuvjatis për mbështetjen e dhe financimin e tij. Realisht, akoma nuk janë dhënë sinjalet e duhura dhe bindëse në këtë drejtim.

Myftiu e ka informuar Kryebashkiakun se gjatë vizitës së bërë para pak ditësh në Ankara, ka kërkuar nga Koordinator i TIKA-s për Ballkanin ndërhyrje dhe mbështetje në lidhje me Xhaminë e Plumbit.

Njëkohësisht, edhe Kryetari i Bashkisë ka konfirmuar vullnetin dhe gatishmërinë e tij për të zhvilluar takimet e duhura me drejtues të TIKA-s në Tiranë, në lobim për këtë çështje.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i ka dhuruar Kryetarit të Bashkisë z. Lorenc Luka, librin e tij më të ri me titull: "Nún – Pasha Lapsin...".





NISIN P PËR NDËRTIMIN NË FSHAT

Pas një pritje të gjatë, muslimanët e fshatit Domën, Komuna Postrisë, kanë përjetuar sot, të xhumanë, më 29 nëntor 2013, një ditë të gëzueshme, me rastin e fillimit të punimeve për ndërtimin e xhamisë së re.

Ceremonia është zhvilluar në një atmosferë gëzimi, që përzier me ajrin e freskët dhe rrezet e diellit, e bënë këtë të xhuma, një ditë të paharruar për banorët e këtij fshati, thuajse të izoluar në mesin e maleve të zonës.

Ceremonia ka nisur me fjalën e hapjes të mbajtur nga teologu Ervil Kuçi, që ka shpjeguar qëllimin e këtij tubimi, lajmin e gëzueshëm për banorët e Domnit, si dhe vlerën dhe rëndësinë që ka xhamia në një komunitet besimtar.

Më pas, duke përshëndetur të pranishmit dhe në veçanti Kryetarin e Komunës Postrisë, z. Faz Shabaj dhe Drejtorin e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, Myftiu i Zonës Shkodër Imam Muhamed Sytari, ka shprehur emocionin dhe gëzimin e tij për mbërritjen e kësaj dite të mbarë për fshatin Domën. Myftiu ka vlerësuar se kjo ditë e shumëpritur nga të gjithë, erdhi si një dhuratë hyjnore për krejt muslimanët e Postrisë dhe Shkodrës.

Në mënyrë simbolike, Myftiu ka vendosur gurin e parë të themelit,



UNIMET E XHAMISË SË RE IN DOMËN

me lutjen që kjo xhami e re të përfundojë sa më parë, me cilësinë e priturbur dhe të jetë një busull orientimi për të rinjtë dhe banorët e fshatit.

Ceremonia është përshëndetur edhe nga Kryetari i Komunës Postribë, z. Faz Shabaj, që ka shprehur vlerësimin e tij për këtë investim që po bëhet në Postribë, duke vlerësuar njëkohësisht ndërtimin e kësaj xhamie të re si një kërkesë të kahershme të besimtarëve të Domnit.

Në emër të donatorit, Drejtori i Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja ka theksuar se është mirësi e All-llahut, që u mundësua realizimi i këtij bashkëpunimi, në rrugën e ngritjes së xhamisë së re në fshatin Domën. Ai ka falënderuar bashkëpunimin me Myftininë Shkodër, duke vlerësuar njëkohësisht frymën e mirëkuptimit për ringritjen e infrastrukturës shpirtërore në Shkodër e Shqipëri.

Me rastin e kësaj ceremonie, Myftiu i Shkodrës i ka dhuruar z. Korab Kaja, "Pasaportën e Resulull-llahut (a.s)", si shenjë mirënjohje për këtë kontribut dhe bashkëpunim për xhaminë e re të fshatit Domën.

Në fund të ceremonisë, imami i xhamisë Domën, z. Smajl Braqi, ka shprehur mirënjohjen e tij për Myftininë Shkodër, Komunën Postribë dhe Fondacionin "Mirësia", për këtë angazhim të vlerësuar në shërbim të ngritjes së kësaj xhamie të re në Domën.



MYFTIU JEP NJË INTERVISTË TË GJERË PËR GAZETËN ONLINE “HERMES NEWS”



Paraditën e së martës, më 19 nëntor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka dhënë një intervistë të gjerë për gazetaren Doriana Metollari, drejtuese e gazetës online “Hermes News”.

Në këtë intervistë Myftiu ka folur mbi aktivitetin e Myftinisë Shkodër në disa drejtime, si në atë fetar, bamirës, kulturor, shkencor, botues dhe interesimin e tij për të zhvilluar më tej vakëfin e shenjtë, si një trashëgimi e brezave dhe amanet i shenjtë islam.

Myftiu ka folur edhe për objektivat e Myftinisë Shkodër në drejtim të rritjes së mëtejshme ekonomike, me qëllim marrjen e përgjegjësi që i takojnë këtij institucioni që përfaqëson besimtarët muslimanë të Zonës Shkodër dhe interesat e tyre legjitime në shumë drejtime.

Gjatë intervistës është folur edhe për qëndrimet e Islamit ndaj feve të tjera, ku Myftiu ka vlerësuar si shumë me rëndësi njohjen reciproke,

mbi të cilën ngrihet respekti, vlerësimi dhe vullneti për dialog, pse jo edhe debati mbi baza teologjike, bashkëpunimi në projekte të ndryshme të përbashkëta me dobi sociale etj. Në këtë kontekst, ka përmendur se Kur’ani ka përmendur në shumë vende profetët e mëparshëm dhe simbolikat e ndryshme të dërgesës së tyre, gjë që e bën muslimanin shumë të gatshëm për të komunikuar me një jomusliman. Njëkohësisht ka theksuar: *“Mbetet që edhe jomuslimanët, kushdo qofshin, të shprehen me të njëjtën mënyrë ndaj muslimanëve, duke njohur profetin Muhammed (a.s) dhe shpalljen e tij, shenjtërinë e Kur’anit si Libër i shpallur etj.”*

Vlera e dijes në Islam dhe mirëpërdorimi i zhvillimit teknologjik, si një nxitje kur’anore dhe urdhëresë profetike, ka qenë një ndër pikat e shumta të kësaj interviste, ku Myftiu ka theksuar se muslimani është një individ që udhëzohet në jetën e përditshme i bazuar mbi porosinë: “Kush i ka dy ditë të barabarta është në humbje” dhe lutjen: “Zoti im më

shto mua dituri!”. Në këtë kontekst ka përmendur shembullin pozitiv të dijetarëve dhe shkencëtarëve të ndryshëm muslimanë ndër shekuj, si burim i arritjeve të sotme diturore në botë.

Është folur edhe mbi këndvështrimin islam ndaj profetëve dhe pasuesve të feve të tjera, ku Myftiu ka theksuar se Zoti është Një, ndërsa profetët janë të përzgjedhurit e Tij në kohëra të ndryshme, me një qëllim të vetëm; udhëzimin dhe edukimin e njeriut me frymën e dashurisë dhe orientimit sipas udhëzimit hyjnor.

Në intervistën e tij, Myftiu ka cekur edhe çështjen e femrës, ku ka thënë se në Islam femra është e respektuar dhe e mbrojtur me fanatizëm, për të qenë një individ i ditur, i pastër, i ndershëm, i kulturuar, i gatshëm për të qenë nënë, prej së cilës edukohen brezat me moral, dije dhe përkushtim në jetë.

Myftiu ka folur edhe për nevojën e përfshirjes së edukatës fetare në shkollat publike të Shqipërisë. Ai ka përmendur se edhe pse kanë kaluar 23 vite nga kapërcimi i caktimit të ateizmit dhe diktaturës që ndaloj me ligj fenë dhe edukatën fetare në shkollat e vendit, akoma sot, kjo çështje vazhdon të trajtohet njësoj si në kohën e komunizmit, duke qëndruar larg modeleve evropiane, ku edukata fetare është pjesë e kahershme e kurrikulave në shkollat publike.

Pyetjes së gazetares se a ka vend për një ateist në Islam, Myftiu i është përgjigjur: *“Në Islam ka vend për çdo njeri, pavarësisht realitetit besimor në të cilin ai gjendet. Fakti që në Kur’an ka shumë ajete në të cilat Zoti i drejtohet njerëzimit me: “O ju njerëz”, do të thotë se kushdo është i mirëpritur në dyert e Islamit dhe se çdo njeri ka në zemrën e tij mirësi dhe gatishmëri për t’u kthyer nga origjina e besimit dhe udhëzimit”.*

LOTI IM

NUK MUND TË PUSHOJË KURRË...

Vogëlush, nuk të njoha,
As emrin s'ta di...
Dhembja kalon kontinente,
kalon dhe kufij...

Dhembja për një fëmijë!..

Humbe prindërit.
Me bombë t'i vranë!
Planetin e dashurisë ta humbën...
Planetin e urisë të dhanë...

Numëron ditët me këmbët e zbathura,
ngroh shpirtin me rrënojat e shtëpisë ku linde,
paska edhe të tilla dashuri:
Një zemër e uritur s'ngopet me Vendlindje!..

Mes rrënojave këpucët e babait gjete,
i mbathe, si një liri e munguar,
rrugët do të kishin më shumë ëndrra,
"Tani jam me baba!" – i the Jetës për të jetuar...

Dora jote e vockël si çerdhe e braktisur,
si një thërrime buke e shumëëndërruar!..
Aty në anë të rrugës, si dëshmi tragjike,
aty... si një monument i rrëzuar!..

Zgjohu, bir! Zgjohu..! E di, se je lodhur!..
Të pret një mbrëmje, një mëngjes të pret,
Të pret dhe loti im si një gacë për t'u ngrohur,
Këpucët aty janë si një përkujdesje prindi...

Zgjohu! Ende po fle?..
S'po ta prish ëndrrën. Mund të ikë...
Pranoi loti të kthehet në thërrime buke,
që dritës t'i falësh DRITË...

Zgjohu!
Pushoje lotin tim që s'pushon kurrë...

-një vogëlushi sirian, ku imazhi i tij tragjik shëtit botën-

Shkodër, më 15 dhjetor 2013

Xhahid Bushati, shkrimtar

"100 PERSONALITETE SHQIPTARE TË KULTURËS ISLAME" - vepër me vlera atdhetare, fetare, shkencore dhe shoqërore HAFIZ ALI KORÇA (1873-1957)



Prof. dr. Njazi Kazazi
USH "Luigj Gurakuqi"

Ka disa kohë që kemi në dorë librin: Encikopedi, 100 - personalitete shqiptare të kulturës Islame Shekulli XIX-XX, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Tiranë, 2012, 397 faqe.


Është një libër i veçantë nga këndvështrimi fetar, teorik, fushat e përshtirjes, personalitetet që rrok, vlerat që trasmeton dhe mesazhet që jep. Libri në fjalë që përmbledh 100 figura të shquara të dy shekujve të fundit XIX-XX. Në faqet e librit ne njihemi me disa nga figurat më të shquara të kombit si: Daut Efendi Boriçi (Drejtor arsimit, kryetar i Lidhjes së Prizrentit, dega Shkodër; gjuhëtar, autor abetaresh dhe fjalorësh), Hasan Tahsini (Rektor i parë i Universitetit të Stambollit), Hafiz Esat Myftia (Drejtor i medresesë Shkodrës dhe Tiranës), Haxhi Faik Hoxha (Myfti i zonës së Shkodrës, në vitet 1991-2003, Pishtar i Demokracisë, Qytetar Nderi), Ferit Vokopola (firmëtar i aktit të Pavarësisë), Hafiz Halid Bushati, Haxhi Hasan Alia (Sheh Shamia), H. H. Dr.

Hasan Ef. Kaduku (mjek i parë stamatolog shqiptar), Hafiz Sabri Bushati (Anëtar i Senatit të Qeverisë së Kongresit të Lushnjës, një rrugë e qytetit mban emrin e tij), Haxhi Hafiz Sabri Koçi (Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, 1990-2003 dhe drejtues i ceremonisë fetare më 16 nëntor 1990), Said Najdeni (Hoxhë Voka), Salih Efendi Myftia (myfti i zonës Shkodër dhe Kosovë, prijës i shqiptarëve në SHBA), Selim Efendi Çoba, Selim Efendi Gashi (Drejtor i Medesës së Tiranës), Mulla Sherif Ahmeti (përkthyesin Kur'anit në shqip), Hafiz Sheuqet Boriçi, Shuqet Muka (mësues dhe autor librash shkollorë), Tahir N. Dizdari (autor i librit "Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe", Tiranë, 2005, faqe 1202), Haxhi Vehbi Dibra (Agolli), Haxhi Vehbi S. Gavoçi (autor i dhjet-

ra librave në shqip dhe në gjuhë të huaj), Imam Vehbi Ismaili, Vexhi Buharaja ("Mësuesi i Popullit"), Xhemal Naipi (kryetar i komisionit të arsimit), Hafiz Ymer Bakalli, Ymer Haxhi Prizreni (udhëheqës i qeverisë së Lidhjes së Prizrenit), Hafiz Ali Kraja (Tari), H. Hafiz Abaz Golemi (themelues i shkollës së Parrucës), Hafiz Abdullah Bërdica, Hafiz Adem Kazazi, Sheh Ahmet Shkodra, Hafiz Ali Ulqinaku (myfti, poet, gjuhëtar, "Mësuesi i Popullit", 1994), Hafiz Ibrahim Dalli (autor librash dhe traktatesh filozofike), Hafiz Ibrahim Kaduku (mësues dhe edukator i nderuar), Hafiz Ibrahim Repishti (deputet, imam, politikan), Sheh Ibrahim Karbunara (politikan, i pushkatuar nga komunizmi), Imam Isa Hoxha (Imam në SHBA), Hafiz Ismet Dibra (drejtor i Medresesë Tiranë), Jusuf Efendi Tabaku (një jetë në tre shekuj, "Mësuesi i Popullit"), H. Hafiz Muhamet Bekteshi (me veprimtari të dendur dhe për disa dekada ndër protagonistët e jetës fetare e shoqërore), Hafiz Myrteza Vuci, Osman Met Osja (zv/drejtor i medresesë së Shkodrës, nëpunës biblioteke e vaiz), Sheh Qazim Hoxha, Rexhep Voka, Xhemal Naipi (kryetar i komisionit të arsimit, myfti etj.).

Pra, siç shihet janë përfshirë nga të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët me përfaqësuesit kryesorë që i dhamë, por të na falin se nuk i përfshimë të gjithë, për mungesë kohe.

Pa u zgjatur të gjithë hoxhallarë, imamë të besimit



Islam, por edhe qytetarë, atdhetarë, mësues e drejtues të arsimit, autorë librash e veprash fetare dhe filozofike të gjithë në shërbim të popullit dhe Atdheut.

Gjatë studimeve tona kemi shkruar edhe për Duat Efendi Boriçin e Hafiz Ali Korçën kur kemi botuar me Prof. dr. Shefik Osmanin librin tonë për “Abetaret shqipe...” botim i MASH, Tiranë 2000.¹

Po japin në mënyrë të përmbledhur diçka për Hafiz Ali Korçën, për të treguar se kështu është shkruar gjatë gjithë librit.

*“Hafiz Ali Korça i përket atij brezi ideologesh e organizatorësh, që më veprimtarinë e tyre i bënë një shërbim të denjë çështjes së zgjimit dhe bashimit kombëtar, çështjes së tërësisë dhe pavarësisë së Atdheut dhe çështjes së përparimit të kombit”.*²

*“Midis hoxhallarëve të përndjekur nga fanatikët dhe komunizmi për idetë, pikëpamjet dhe veprimarinë e tyre është edhe Hafiz Ali Korça”,*³

Hafiz Ali Korça, duke përkthyer kryeveprat si “Gjylstani”, “Rubairat” si dhe “Jusufi me Zelihane” i bëri të flasin në shqip poetët e mëdhej si Saadiun, O. Kajamin etj. siç la një kontribut të shquar me veprat origjinale në prozë e poezi fetare dhe laike në një periudhë të gjatë kohore

mes vitetve 1900-1942.

Kujtojmë se më 1925 botoi në Tiranë pamfletin “Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit”, ku shprehu pikëpamjet e tij për komunizmin.

Ai botoi në Korçë edhe një “Abetare shqip” (1910) etj. Abetarja është shtypur në shypshkonjën “Korça” në



HAFIZ ALI KORÇA - (1873-1957)

Korçë, gjeti miratim të përgjithshëm në publik, sepse ishte në korent të lëvizjes arsimore-kulturore për abetarin shqip.

Një nga autoritetet e kohës që mori pjesë aktive në këto ndërmarrje që edhe Hafiz Ali Korça, i njohur si erudit, poliglot, mësues i “Mësonjëtores së parë shqipe të Korçës”, (... “bashkëpunoi ngushtë me Pandeli Sotin, drejtorin e kësaj shkolle... Aty dha pa pegasë Edukatën Islame.”⁴ për-

faqësues i nacionalizmit shqiptar, i dënuar me vdekje për pikëpamjet e tij.

Në këtë tekst autori përdori dy alfabetë: Alfabetin e Stambollit (variantin e vitit 1884) dhe alabetin e Kongresit të Manastirit (1908). Kështu autori bëri i pari publikimin e këtij alfabeti në një abetare dhe është meritë e Hafiz Ali Korçës.

Copat e leximit që vijnë menjëherë pas pjesës së shkronjave, janë të gjitha në prozë. Ato përshkohen nga edukimi moral dhe janë të lidhura me problemet e jetës së përditshme dhe synojë të edukojnë tek nxënësit të vetive të mira morale, si: dashurinë për Allahun (xh.sh.) mirësjelljen, dashurinë për prindërit dhe njëri-tjetrin etj. Fjalët e urta të nxjerra nga folkori popullor dhe që janë vendosur në fund të tekstit, ia vlerat edukative të tij.

Botimi i kësaj abetareje përbën një kontribut të madh në kushtet e pushtimit, mungesës së librave në gjuhën shqipe, në prag të Pavarësisë. Teksti ka përmbatje pa asnjë dallim dallim dallim fetar, gjë që

përçon platformën e rilindësve në planin e edukimit atdhetar dhe arsimor.

Abetarja ka një vëllim të konsiderueshëm dhe shërbeu për disa vite me radhë për mësimin e leximshkrimit e gjuhës shqipe nga masat e popullit.

Në mbyllje themi me plotgojën: Ju begatoftë Allahu (xh. sh.) zemrën, ju driçoftë mendjen, ju dhashtë durimin për për vepra të reja, të dobishme grupit të autorëve që kanë bashkëpunuar për librin.

1. Shefik Osmani, Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe dhe trajktoria e tyre historiko-pedagogjike”. Botim i MASH, Shtëpia botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, fq. 366.

2. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, “Enciclopedia, 100- personalite shqiptare të kulturës Islame, shekulli XIX-XX”, Editor Genti Kruja, Andrin Rasha. Tiranë, 2012, fq. 24-27.

3. Dr. Ramiz Zeka në “Zhvillimi i kulturës Islame të shqiptarët gjatë shekullit XX”, Ribotim, Tiranë, 2002,

4. Po aty, fq. 318

Inspektohen punimet në disa vakëfe të Myftinisë Shkodër

Ditën e mërkurë, më 20 nëntor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, i shoqëruar edhe nga menaxheri i pronave z. Blendi Alushi, ka zhvilluar një inspektim në terren, për të vëzhguar nga afër gjendjen e punimeve në disa prej vakëfeve të Myftinisë Shkodër.

Fillimisht është bërë inspektimi i vakëfit në lagjen Dudas, ku me mbarësinë e All-llahut, shumë shpejt pritet të finalizohet përpjekja e Myftinisë Shkodër për ndërtimin e një xhamie të re, e munguar prej dekadash në këtë lagje të vjetër muslimane.

Më pas, Myftiu ka ndjekur nga afër punimet që po vijnë për ndërtimin e xhamisë së re në zonën e ish-Zukthave, te vakëfi i vjetër i xhamisë që mbante emrin e bamirësit dhe hatibit të saj, Shaban Efendi.

Një problem në rrugën e ndërtimit të xhamisë së re qëndron një godinë e vogël, e ndërtuar mbi truallin e Myftinisë Shkodër, e legalizuar padrejtësisht në vitet e fundit nga ALUIZNI Shkodër. Myftinia Shkodër po bën të gjitha përpjekjet për ta pastruar këtë territor, në mënyrë që projekti i xhamisë të plotësohet tërësisht.

Është inspektuar edhe gjendja aktuale e vakëfit të Ura e Bunës, ku prej një viti ka nisur puna për ndërtimin



Lagja Dudas dhe fshati Domën, së shpejti me xhami të re

Ditën e enjte, më 21 nëntor 2013, Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari ka pritë në një takim pune Drejtorin e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja.

e xhamisë së re. Pas përfundimit të minares me dy ballkone, që e ka zbuluar krejt zonën, vijimi i punimeve do të bëjë të mundur përfundimin e xhamisë së re, mbi themelet e xhamisë së vjetër që ekzistonte më parë në këtë zonë.

Në ditët vijuese, Myftinia Shkodër do të vazhdojë përpjekjet e saj për të arritur çertifikimin e vonuar të krejt pronave të saj, lirimin e vakëfeve të uzurpuara, si dhe lobimin për vënien në efikasitet të tyre me ndërtime të reja.

Në qendër të këtij takimi ka qenë lobimi i Myftinisë Shkodër për ndërtimin e dy xhamive të reja, njëra në lagjen Dudas dhe tjetra në fshatin Domën, Komuna Postrinë.

Në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm në mes të dy institucioneve, z. Korab Kaja, ka garantuar Myftiun e Shkodrës se me mbarësinë e All-llahut, Fondacioni "Mirësia" do të marrë përsipër mbështetjen financiare për ndërtimin e këtyre dy xhamive, për të cilat ka marrë kërkesë zyrtare nga Myftinia Shkodër.

Gjatë këtij takimi është folur edhe për mundësinë e shfrytëzimit të kohës më të afërt të përshtatshme për hedhjen e themeleve dhe nisjen e punimeve për dy xhamitë e reja.

Ndërtimi i xhamisë së lagjes Dudas planifikohet të bëhet mbi një pjesë të vakëfit të lirë të Myftinisë Shkodër, ndërkohë po punohet për lirimin e pjesës tjetër të vakëfit të çertifikuar ditët e fundit, pas një zaptimi rreth 17 vjeçar në mënyrë të padrejtë.

Myftinia Shkodër planifikon që të shfrytëzojë maksimalisht këtë vakëf në shërbim të projekteve të saj, që do t'i japin dritën e shumëpritur kësaj lagjeje të vjetër muslimane me xhami të munguar.

Njëkohësisht, edhe në fshatin Domën, pritet të caktohet dita më e përshtatshme për fillimin e punimeve për xhaminë e re, në një kohë kur besimtarët e këtij fshati i kryejnë adhurimet e tyre në një objekt të amortizuar në një zonë malore të vështirë.





Arben Halluni - teolog

VETËM ME BESIM!

hyjninë e Zotit, kështu që nuk njih ndërmjetësim me fuqinë e Allahut.

Nga ana tjetër, besimi i shëndoshë është baza e shoqërisë Islame, ndërsa monoteizmi është esenca e këtij besimi dhe shpirti i gjithë Islamit. Me anë të sheriatit dhe udhëzimeve feja Islame mbron këtë besim dhe monoteizmin e pastër nga besimet e kota dhe bestytnitë. Ai gjithashtu i lufton besimet pagane të cilat ishin të njohura në periudhën idhujtare, me qëllim që ta pastrojë shoqërinë Islame nga idhujtaria dhe rruga e humbur.

Nga ana tjetër, zakonet me natyrën e tyre ndërrojnë. Nuk mund të gjejmë një zakon që të mos jetë ndërruar

tillë i ngjan edhe çështjes së besimit. Njerëzit në të kaluarën dhe sot adhurojnë Zotin.

Në historinë njerëzore s'ka pasur periudhë që njerëzit të mos njihnin fenë dhe besimin të Zoti. Megjithatë në çdo kohë dhe vend kanë ekzistuar disa forma besimi. Kuptohet qartë pra arsyeja pse adhurimi i Zotit vjen nga thellësia e shpirtit dhe burimi i tij është fitrati (pastërtia Islame) i qenieve njerëzore dhe jo rrjedhojë e zakoneve siç bëjnë disa që e mbështesin këtë hipotezë, sepse po të ishte kështu ky adhurim s'do të ishte kaq i gjërë dhe i përjetshëm. Natyrisht, kur njerëzit nuk e njihnin Zotin si një Qenie që është mbi natyrën, ata

e kërkonin Atë dhe duke e kërkuar kthyen në idhuj shumë objekte e krijesa të natyrës.

Me zhvillimin e mendimit qeniet njerëzore u bënë të zotët të shihnin të vërtetën, nuk adhuruan më idhujt që ishin krijesa materialiste dhe përqaftuan besimin në një Zot të vetëm. Faktori më i madh për kthimin në përgjithësi të njerëzve në besimin në monoteizëm

(njësueshmëri, besimi në një Zot) ishte Shpallja Hyjnore. Njerëzit nuk janë përgjegjës për besimin e tyre të gabuar, përderisa nuk janë të njohur me Shpalljen Hyjnore apo me Pejgamberin që do të kumtojë Fjalët e Zotit xh.sh, sepse pikërisht për këtë në Kur'anin Fisnik thuhet: "Ne nuk kemi ndëshkuar një popull, përderisa nuk kemi dërguar një Pejgamber (me shshpallje)".

Pra si përfundim, dashuria për Zotin ka ekzistuar dhe do të ekzistojë gjithmonë për ne. Jo vetëm kaq por besimi të Zoti është një flakë e përjetshme, e cila ngroh shpirtin e çdo njeriu...

Pa dyshim se besimi është një pemë e bukur. Frytet që ajo jep, gjithmonë me lejen e Allahut xh.sh, janë me cilësi të larta shpirtërore. Këto virtyte njerëzore duhet të reflektohen në këtë mënyrë:

Së pari: besimin që kemi përbrenda, ta njoftojmë me deklaratën e Dëshmisë.

Së dyti: me fuqinë e këtij besimi të mbahemi pas urdhërave të Allahut xh.sh, të ruhemi nga ndalimet dhe këtë qëndrim ta vazhdojmë hapur e fshehur në punët personale e kolektive, në adhurim, në sjelljet tona, shkurt në çdo vend.

Së treti: ta përhapim këtë besim tek njerëzit, domethënë t'i nxisim të tjerët të veprojnë mirë e drejt, të ndikojmë që të ruhen nga të vepruarit keq e gabim.

Besimi e lidh myslimanin me Zotin e tij. Besimi është natyrshmëri dhe jo dije, ndjenjë dhe jo filozofi, moral dhe jo mendim. Besimi është gjithashtu një litar që lidhet midis myslimanit dhe qëllimit të tij dhe midis myslimanit dhe atij që ka besuar me të. Nuk ka lidhje më të fortë se besimi dhe nuk ka besim më të fortë se Islami.

Besimi Islam është feja e vetme e pastër e cila nuk adhuron tjetër përveç Allahut një dhe vetëm Atij i drejtohem. Besimi Islam nuk njih rivalitet, ngjasim apo trupëzim me



gjatë historisë në të gjitha kombet dhe vendet. Kështu meqenëse kanë ekzistuar në të gjitha kohët duhet të kuptojmë që rrënjët e besimit të Zoti Fuqplotë kanë fitratin (pastërtia dhe natyra Islame që lind bashkë me njeriun) dhe ai pa dyshim është i gërshetuar me shpirtin e qenieve njerëzore. P.sh. dashuria e nënës për fëmijën. Nuk mund të thuhet dhe të konkludohet se kjo vjen nga propaganda ose nga zakoni, sepse s'ka fis ose komb në çdo kohë dhe epokë që një nënë të mos dojë fëmijën e saj. Pra është një instikt i lindur, një dhunti që Zoti xh.sh ia ka dhënë krijesës së gjallë. Një shembull të

**Myftinia Shkodër
merr pjesë në ceremoninë
e 101 vjetorit të Shqipërisë**



Paraditën e së enjtes, më 28 nëntor 2013, në të gjitha trojet shqiptare është përkujtuar 101 vjetori i ngritjes së flamurit tonë kombëtar në Vlorë, që shënoi edhe pavarësimin e Shqipërisë dhe nisjen e rrugëtimit të saj si një vend i lirë dhe i pavarur.

Edhe në Shkodër, Bashkia e qytetit ka organizuar një ceremoni modeste, në sheshin para godinës së Bashkisë, në kujtim dhe nderim të kësaj date të shënuar kombëtare.

Në këtë tubim tashmë tradicional, ka marrë pjesë edhe Myftiu i Shkodrës Imam Muhamed Sytari, i shoqëruar nga imamët H. Fejzi Zaganjori dhe teologu Idmir Plaku.

Fillimisht, Myftiu ka uruar Kryetarin e Bashkisë z. Lorenc Luka, Prefektin e Qarkut z. Paulin Radovani, deputetet e ndryshëm, drejtuesit e institucioneve lokale dhe përfaqësuesit e komuniteteve të tjera fetare me rastin e 101 vjetorit të Shqipërisë, si dhe është lutur që Zoti me madhërinë e Tij ta begatojë këtë tokë dhe njerëzit e saj.

Pas ceremonisë së këndimit të himnit kombëtar dhe ngritjes së flamurit, Myftiu ka dhënë një intervistë për mediat lokale, ku ka vlerësuar këtë ditë si më të shtrenjtën ditë të shqiptarëve, në të gjitha trojet e tyre dhe në diasporë.

Myftiu është lutur për të gjithë ata që kontribuan për rritjen dhe zhvillimin e Shqipërisë, si dhe ka bërë thirrje që shqiptarët të punojnë përditë e më shumë për të mirën e vendit dhe kombit.

NË VITET 1300,
MBRETI KINEZ HONGU SHKROI
“100 FJALË ELEGJIKE”,
KU PËRSHKROI CILËSI DHE KARAKTERISTIKA
TË PROFETIT MUHAMED (A.S).
KOPJE TË SAJ JANË SHPËRNDARË
NË XHAMI TË NDRYSHME NË KINË.

Që me krijimin e Universit,
Zoti e kishte caktuar tashmë
mëkëmbësin e Tij të madh.
I lindur në Perëndim
pranoi shkrimin e shenjtë
librin me 30-të pjesë.
Për të udhëhequr gjithë krijesat,
Mjeshtri i të gjithë sunduesve,
Lideri i të shenjtëve,
me mburojën qiellore,
për të mbrojtur vendin e tij.
Me pesë lutje të përditshme,
duke shpresuar për paqen në heshtje.
Me zemrën drejtuar Zotit,
duke i dhënë fuqi të varfërve,
duke i shpëtuar ata nga skamja.
Duke parë përmes së fshehtës,
duke tërhequr shpirtrat larg nga veprat e liga.
Mëshirë për të gjithë botët.
nëpërmjet së kaluarës,
rruga madhështore që zhduku të keqen.
Feja e tij e pastër dhe e vërtetë,
Muhamedi,
Fisniku më i lartë.

Përktheu nga anglishtja: I. Krymi
Marrë nga faqja: Lost Islamic History

PROCESVERBAL I KRIJIMIT TË BASHKËSISË ISLAME - 16 NËNTOR 1990

PROCES VERBAL

/ Krijimit të Bashkësisë Islamike /

I mbajtur sotme dt 16.11.1990 me rastin e kriimit të bashkësisë Islamike me qendër në qytetin e Shkodrës.

Në dt e lartepërmendur në përfaqësimin e popullsisë myslimane të rrethit të Shkodrës të mbledhur në xhaminë 217 vjeçare të përbërë në lagjen Tabake, vëre në jete dëshirën e gjithë besimtarëve myslimane për rikrijimin e Bashkësisë Islamike, pas 23 vjetësh. Me këtë rast vihat në dukje kontributin e rinisë myslimane, e cila me të gjitha energjitë e sajë punoi për rishtesimin në një kohë shumë të shkurtër të xhamisë së plumbit. E përkrahur në këtë xhami u bë mbledhje për rikrijimin e kësaj bashkësie, si qendër kryesore për gjithë vendin tonë.

Po në këtë dt u fal për herë të parë pas një ndërprerje 23 vjeçare e Xhamisë në këtë fshat, ku morën pjesë rreth 5500 vete. Pjesën e restit në këtë ceremoni e mbajti hafiz Sabri Koci. Për këtë ceremoni të parë ruhen dokumentet përkatëse, si kaseta që ka filmimin dhe fotografite e ndryshme, e ftesat.

Për të gjitha këto veprimtari një ndihmesë kryesore dhe shtëpi e Myftisëve në lagjen Tabak.

Kjo veprimtari vartetohet me nënshkrimet e të gjithë pjesëmarrësve që përbejnë komisionin organizator.

1 Hafiz Sabri Koci. 2 Xhevdet Lluja. 3 Nut Dragusha. 4 Shefqet Bushati.

5 Xhevdet Myrtis. 6 Hamit Lluja. 7 Rifet Berdica. 8 Rasim Sokoli.

9 Daut Logu. 10 Rasim Zekja. 11 Abdyl Sokoli. 12 Mit'hat Myrtis

13 Hamza Cangu. 14 Ferit Lluja. 15 Minir Koci. 16 Abdullah Myrtis

17 Eljaz Peteriku 18 Ferit Zaganjori. 19 Selim Jakupi. 20 Lutfi Berdica.



28 NËNTOR 2013



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

E-mail:
udhaislame@myftinia-shkoder.org
Website:
www.myftinia-shkoder.org